33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një **certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një **certifikatë të pranimit të përkohshëm** jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit **certifikatën e pranimit të përkohshëm** me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar **certifikatën**.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë **certifikatën e pranimit të përkohshëm** ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar **certifikatën** në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me

një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të paralizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është nuk kerkohet
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve 2.500 € (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve 2.500 € (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën 2.500 € (d) dëmtim personal ose vdekje: <i>(i)</i> të punëtorëve të Kontraktuesit: 5.000 € <i>(ii)</i> të personave të tjerë: 5.000 €
Programi	12.1	Projekti do të realizohet në pajtim me Planin Dinamik dhe Planin për Menaxhimin e Kontratës konform nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 mbrenda 3 diteve nga data e nënshkrimit të kontrates. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 5 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 10.11.2019 , sipas Planit Dinamik dhe planit për menagjimin e kontratë, nga data e urdhërësës për fillimin e punimeve <i>deri në pranim Teknik Përfundimtar të punimeve.</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.05% për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Shërbimeve përkatësisht Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë dhe evidentojnë shërbimet e

		përfunduara në Planin për Menaxhimin e Kontratës, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e shërbimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar numrin e ditëve të ekzekutuara, cilësinë e shërbimeve, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e shërbimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të shërbimeve, për të dhënë në baza mujore një Raport me shkrim për të konfirmuar ecurinë e shërbimeve përmes të dhënave në shifra dhe data. Mbi bazën e të dhënave në Raport do të lejohet edhe pagesa për ekezekutim të shërbimeve për muajin gjegjës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menagjeri i projektit: do të emërohet me vendim të veçantë nga Zytari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të shërbimeve në terren, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Ligjin për Komunikacionin dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin. Menagjeri i kontrates: Bean Haxhiasan Menaxheri i Projektit te Autoritetit Kontraktues(organi mbikqyres) është Sabahat Hasani , ndersa Menagjeri i Operatorit Ekonomik eshte: Ulpian Tahiri.
Parapagimi Pagesat	26.1	- Nuk do te kete - Pagesa do te behet ne fund me pranimin teknik te puneve nga ana e komisionit per pranim teknik(te percjellura me ditarin e punes dhe librin ndertimor).
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 1.937.67 €,per nje vit nga data e pranimit teknik te puneve
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia Defektet mbi	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë Kontraktuesi është përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve të kontraktuara në cilësi, sasi dhe përshtatshmëri me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet ne Gjykatën Themelore në Prizren-dega Dragash në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

A					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR REHABILITIMIN E UJËSJELLËSIT NË FSHATIN KOSAVË					
1	Punët Parapregaditore	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit, Kompania punë kryese është përgjegjëse për t'i marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjeteet sinjalizuese para fillimit të punët, nëqëllë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntokësore tëqytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1.1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet rrjeti i ujësjellësit, si dhe në zonat ku do të kontrollohet dhe testohet rrjeti ekzistues sipas projektit detal , gjatë kohës sa zgjatim punimet .Llog në m'	m	1860.00	€ 0.05	€ 93.00
1.1.2	Punët parapregaditore, shënimi gjeodezik i gypit kryesor furnizues të ujësjellësit të rrjetit të ri , kaptazhave , ujëmbledhësit deri në rezervuarin kryesor në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike,Llog në m1	m	1860.00	€ 0.05	€ 93.00
Gjithsej: Punët Parapregaditore					€ 186.00
2	Punët e pastrimit dhe demollimit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
Shkryja e dhe rikryja e rrjetit të ri të ujësjellësit duhet bëhet në përputhje me projektin , standardet evropiane dhe Eurokodin . Kompani punë kryes fillimisht duhet ta instaloj rrjetin e ri pastaj shkryqjen dhe demontimin e rrjetit të vjetër ekzistues në mënyrë që komuniteti të mos mbetet pa ujë.					
2.1.1	Pastrimi i terentit nga mbeturinat,e ngurta,shkurret drunjët- në zonën blëshkë ku do të kalojë rrjeti furnizues për zgjerim të kapaciteteve ,DN90 dhe DN 63. Pastrimi i tyre bëhet normal me rrjedhën e ujësjellësit me gjerësi 1m sipas projektit për ti mundësuar kompanisë punë kryese hapjen e kanalit , si dhe largimin e largimin e mbeturinave të krijuara në deponi,Deponin e cakton investitori.Llog .në m' VËREJTJE : Punimet do të kryhen me makineri aty ku ka mundësi të shkoj makineria pjesa tjetër me dorë për shkak se zona e punimeve zhvillohet në terene të ashpër, të thepsura me lartësi 1434.00m, është e pa mundur që të transportohen të dërgohen makinerit e rënda për hapjen edhe gërmin e kanaleve , kaptazhës në burime , si dhe drenazhimt përreth kaptazhës	m'	1860.00	€ 0.10	€ 186.00
Gjithsej: Punët e demollimit					€ 186.00
3	Punët Tokësore	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
3.1.1	Gërmimi dhe Hapja e kanalit të kategorisë V- VII tokë shkëmbore-bjeshkore,deri në thellësinë 1.50 m' për rrjetin e ri shpërndarës të ujësjellësit, zvendësimin e atij të vjetër prej kaptazhave të burimeve gjithësejtë 3 copë , në ujëmbledhës deri në rezervuarin me qëllim të ngjites së kapaciteteve për shfrytëzimin e ujit për nevoja të komunitetit të Fshatit Kosovë (Lagjet Mejzini , Kolloni , Terlini ,Beseni dhe Kalanderi) .Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibrator pjesa e trasës së ujësjellësit, duhet patur kujdes sidomos të gypit të ri për zgjerimin e kapaciteteve me Dimenzione DN90 dhe DN 63mm, të mbrohet nga shafitja/deformimi i kanalit Sqarim: sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punë kryesit, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Punët me dorë (60%) Punët me makineri (40%)	m3	558.00	€ 3.00	€ 1,674.00
3.1.2	Gërmimi dhe Hapja , të kategorisë V- VII tokë shkëmbore-bjeshkore,deri në thellësinë 1.50 m' për hapjen e pusëtës për vendosjen e pusetat P1 dhe P2 , ku do të instalohen valvula e ajrit në rrjetin e instaluar të ri furnizimit në lagjen Mejzini -Terlini . Llog në m3 VËREJTJE : Punimet do të kryhen me makineri aty ku ka mundësi të shkoj makineria pjesa tjetër me dorë për shkak se zona e punimeve zhvillohet në terene të ashpër, të thepsura me lartësi 1434.00m, është e pa mundur që të transportohen të dërgohen makinerit e rënda për hapjen edhe gërmin e kanaleve , kaptazhës në burime , si dhe drenazhimt përreth kaptazhës Punët me dorë (60%) Punët me makineri (100%)	m3	2.40	€ 10.00	€ 24.00
3.1.3	Furnizimi dhe shtrirja e Rrës 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim 23cm, dhe 15 mbl gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit , sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë vendosjes së rrës të aplikohet planimetria të përcaktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vepër.Ngleshja sipas normave DIN,DPr 103% Llog m3 VËREJTJE : Është e pa mundur të bëhet furnizimi rrës deri tek zona e punimeve zhvillohet në terene të ashpër, të thepsura me lartësi 1434.00m . Në qmim llogaritet transporti me mjete alternative kuaj , traktor deri në zonë ku ka mundësi të depërtojë. Llog me m3 duke përfshirë edhe shtrirjen e rrës me dorë nën dhe mbl gyp për gjatë trasë ku shtrihet rrjeti ujësjellësit të ri.	m3	1.6	€ 10.00	€ 16.00
3.1.5	Rrë (0-1) mm Furnizimi dhe shtrirja e zhavorit 0-63mm, trashësi 20cm nën pusëtën P1 dhe P2 ku do të instalohen valvulat e ajrit, Zhavorit i hedhur duhet shtrihet , ngjeshet mirë me makinë vibruese me qëllim si dhe pregaditjen finale të bazamentit para se të hudhet shpenzimet e nevojshme. Ngleshja sipas normave DIN,DPr 103% Zhavorr me glanumetri (0-63)mm	m3	232.50	€ 4.00	€ 930.00
3.1.6	Largimin e ujërave nëntokësorë me pomë të cilët shfaqen gjatë gërmimit të kanalit, të cilët pengoj ecurin e punës në instalimin e rrjetit të ujësjellësit. Duke marrë parasysh që një pjesë e ujësjellësit kalon në zonën në afërsi të prrocës dhe lëshesave të rrugës mbikqyrës.	m3	1	€ 20.00	€ 20.00
3.1.7	Angazhimi i pompës për largimin e ujërave nëntokësorë Vendosja e trakës mbrojtëse detektuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasës së rrjetit të ujësjellësit , për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.	orë/pune	5	€ 50.00	€ 250.00
		m'	1860.00	€ 0.49	€ 911.40



3.1.8	Vendosja e trakës mbrojtëse shirizuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasës së rrjetit të ujësjellësit, për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.	m'	1860.00	€	0.01	€	18.60
3.1.9	Mbushja dhe mbulimi i kanalit pas instalimit të rrjetit ujësjellës me sasi të dheut të përgjeshur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detaleve të përcaktuara në projekt për secilin pusete /stacionazh, pastaj vendoset pjesa tjetër e dheut deri në mbushje përfundimtare të terenit dhe këllimi në gjendje të mëparshme, dheu i tepër largohet në deponim më të afërt të caktuar nga organi mbikëqyrës. Në qmim llogaritet mbushja dhe mbulimi i kanalit me dorë duke angazhuar makinerinë dhe fuqinë punëtore	m3	558.00	€	0.50	€	279.00
Gjithsej: Punët tokësore						€	6,634.00
5	Punët e ndërtimit dhe betonimit pusetave	Njësia	Sasia	Çmimi njësi		Çmimi i tërë	
Në këtë pozicion përfshihen ndërtimi i pusetave: sipas projektit dhe detaleve dhe përshkrimeve teknike, në përputhjen me normativin ndërtimor në fuqi si dhe standardet ISO 9001/2008, në pusetë P1 ku do të vendosen dhe instalohen valvula e ajrit në pika kritike ku kemi plasaritje (pëcticje) të rrjetit ekzistues.							
5.1.1	Furnizimi, kallupimi dhe betonimi i shtresës së varfër të tamponit me një trashësi prej 5 cm. Tamponi i vendosur mbi shtresën e parapërgatitur me shtresë të zhavorrit pas atestimit të Modullit të ngjeshjes. Llogaritja në m3 me të gjitha shpenzimet për pusetat ku janë të instaluar valvulat e lirimit të ajrit. VËREJTJE: Për shkak të pamundësisë të furnizimit me beton në punishte, pasi punimet zhvillohen në terene të ashpër, të thepisura me lartësi 1434.00 m. Në qmim llogaritet transporti me mjete alternative kuaj, traktor deri në zonë ku ka mundësi të depërtojë: furnizimi i zallit dhe çimentos si dhe punimi në vend i betonit të varfër me përzierje betoni duke shfrytëzuar energjinë elektrike nga gjeneratori.	m3	0.60	€	70.00	€	42.00
5.1.2	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe vendosja e kondorit 4mm mbi shtresën e varfër të betonit, sipas përshkrimit teknike dhe kushteve veqanta të përcaktuara në projekt. Log në m2 me të gjitha shpenzimet. Transporti me mjete alternative kuaj, traktor deri aty ku ka mundësi të depërtojë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	m2	12.00	€	3.00	€	36.00
5.1.3	Furnizimi, kallupimi dhe betonimi i soletës së poshtme mbi shtresën izoluese mbi kondor si dhe soletën e sipërme në kuotën e nivellit terrenit të pusetave monolite, me klase betoni C 25/30, me trashësi d = 20cm. Reqetës së betonit duhet të shtohen aditive me qelim që masa e betonit krijohet e pa papërkeshme nga uji dhe rezistente ndaj nglicave. Para hüdhes në vepër të betonit duhet të matet konsistenca dhe të hüdhet në vepër në përputhje me teknologjinë betonit, si dhe rregulloret dhe standardet Eurocod 9001/2008. Ekzekutimi i punimeve duhet të bëhet në përputhje me me përshkrimet dhe detalet teknike të përfshira në projekt. VËREJTJE: Për shkak të pamundësisë të furnizimit me beton në punishte, pasi punimet zhvillohen në terene të ashpër, të thepisura me lartësi 1434.00 m. Në qmim llogaritet transporti me mjete alternative kuaj, traktor deri në zonë ku ka mundësi të depërtojë: furnizimi i zallit dhe çimentos si dhe punimi në vend i betonit me përzierje betoni duke shfrytëzuar energjinë elektrike nga gjeneratori.	m3	1.50	€	80.00	€	120.00
5.1.4	Furnizimi, kallupimi dhe betonimi i mureve të pusetës monolite, me klase betoni C 25/30, me trashësi d = 15cm. Reqetës së betonit duhet të shtohen aditive me qelim që masa e betonit krijohet e pa papërkeshme nga uji dhe rezistente ndaj nglicave. Para hüdhes në vepër të betonit duhet të matet konsistenca dhe të hüdhet në vepër në përputhje me teknologjinë betonit, si dhe rregulloret dhe standardet Eurocod 9001/2008. Ekzekutimi i punimeve duhet të bëhet në përputhje me me përshkrimet dhe detalet teknike të përfshira në projekt. VËREJTJE: Për shkak të pamundësisë të furnizimit me beton në punishte, pasi punimet zhvillohen në terene të ashpër, të thepisura me lartësi 1434.00 m. Në qmim llogaritet transporti me mjete alternative kuaj, traktor deri në zonë ku ka mundësi të depërtojë: furnizimi i zallit dhe çimentos si dhe punimi në vend i betonit me përzierje betoni duke shfrytëzuar energjinë elektrike nga gjeneratori.	m3	3.00	€	80.00	€	240.00
Gjithsej: Punët e ndërtimit dhe punimit pusetave						€	438.00
6	Punët e armimit të pusetave	Njësia	Sasia	Çmimi njësi		Çmimi i tërë	
Punimi i armatues sipas detaleve teknike dhe detaleve të armimit të përfshira në projekt sipas llogaritjes statike. Në qmim përfshihen të gjitha							
6.1.1	Furnizimi i hekurit ndërmor, pastrimi, prezja, përpunimi dhe montimi i armatues të hekurit të brinjëzuar, të gjitha në përputhje me standardin Din 488. Llogaritja kalkulohet në kg me të gjitha shpenzimet. Transporti me mjete alternative kuaj, traktor deri aty ku ka mundësi të depërtojë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	kg	720.00	€	0.50	€	360.00
Gjithsej: Punët e armimit						€	360.00
 11.12.2022 20.12.2022 							



DIN 4030 për aplikimin e materialeve hidroizoluese, në çmimet përfshihen të gjitha operacionet e punës, blerjes dhe shfrytëzimit të materialit, mjete shtesë, si dhe vendosjen e skeleve.

7.1.1	Furnizimi dhe lryja mureve të brendshme të pusetës P1 ku është vendosur valvula e ajrit - në mure dhe bazamentit ku janë të vendosura fittingjet po ashtu edhe mureve të jashtme dhe solletës së sipërme të puset me material izolues të ftohtë bitulit. Transporti me mjete alternative kuaj, traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	m2	10.00	€	0.50	€	5.00
7.1.2	Furnizim dhe montimi i shtresës izoluese të hidroizolimit me material hidroizolues sipas standardeve të aplikueshme të cekur në specifikacionin teknik duke aplikuar material material hidroizolues me trashësi 4 mm, vendosja bëhet në të gjithë sipërfaqen e mureve bazamentit dhe pllakës së sipërme të betonit Brenda dhe jashtë pusetës aty ku është mbuluar izolimi me shtresë filestare me bitulit. Materiali hidroizolues vendoset mbi sipërfaqen izoluese të bitulit, vendosje e materialit hidroizolues Index apo ngjajshme bëhet me salldim me flakë. Ulog në m2 .Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	m2	12.00	€	3.00	€	36.00
Gjithsej: Punët e Hidroizolimit Pusetave							€ 41.00
8	Punët e jashtme të pusetës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi		Çmimi i tërë	
8.1.1	Furnizimi dhe Vendosja e folisë PVC për mbrojtjen e shtresave hidroizoluese në pjesën e jashtme të mureve dhe pllakës së pusetave P1 dhe P2, ku janë vendosur valvulat e ajrit. Ulog në m2 ,Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	m2	12.00	€	1.00	€	12.00
8.1.2	Furnizimi dhe vendosja e kapakeve të pusetav Ø800 mm , nga materiali kompozit izoluar me diktun nga goma për mos deperitimin e ujerave atmosferike në pusetat e rrjetit ujësjellësit . Sipas detali të prezentuar në projekt ,Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	copë	3.00	€	90.00	€	270.00
8.1.3	Furnizimi dhe punimi i shkallëve nga metali fi 22 mm anti korroziv i cili perforohet me bulona M8 të cilat duhet të montohen në pusetat kontrolluese me thellësi të rënies=30 cm të hapit të shkallës deri në thellësinë e nevojshme për zbrilje dhe ngritje sipas skicës së projektit. Ulog në copë komplet konstrukcionit i shkallëve me të gjitha shpenzimet, Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore	copë	3.00	€	10.00	€	30.00
Gjithsej: Punët e jashtme të pusetës							€ 312.00
9	Punët montuese (Fittingjet)	Njësia	Sasia	Çmimi njësi		Çmimi i tërë	
Pjesët montuese të vendosjes dhe instalimit të gypit shpërndarës për rrjetin e kapaciteteve të ujit në Komunën e Dragashit, si dhe të fittingjeve Punët Furnizuese dhe montuese të rrjetit të ujësjellësit prej prej kaptazhave të burimeve gjithësejtë 3 copë , në ujëmbledhës deri në							
Bleraj, furnizimi i Gypit PEHD DN 90 mm , 10 bara ; SDR 17, për zgjerimin e rrjetit të ri							
Montimi me salldim i Gypit PEHD DN 90 mm , 10 bara ; SDR 17, duke përfshirë të gjitha shpenzimet (fuqinë punëtore, dhe pajisjet montuese dhe sallduese), Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore		m'	1384.79	€	3.50	€	4,846.77
Bleraj, furnizimi i Gypit PEHD DN 63 mm , 10 bara ; SDR 17, për zgjerimin e rrjetit të ri							
Montimi me salldim i Gypit PEHD DN 63 mm , 10 bara ; SDR 17, duke përfshirë të gjitha shpenzimet (fuqinë punëtore, dhe pajisjet montuese dhe sallduese), Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore		m'	384	€	2.20	€	844.80
Bleraj, furnizimi i Gypit HDPE DN 160mm i brinjëzuar me vrima për drenazhimin e ujit dhe futjen në kaptazha si dhe vendosjen e filtrave drenazhues nga zhavorri fra 31.5/63.5mm.							
Në pozicion përfshihet punët tokësore hapja e kanaleve me dim 0.5x1.50m ,si dhe furnizimi ,montimi dheinstalimi i Gypit HDPE DN 160mm i brinjëzuar për drenazhimin dhe grumbullimin e ujit përreth kaptazhave në burime , në qmim illogaritët edhe vendosja e filtrave nga zhavorri. Ulog komplet për tri kaptazhat duke illogaritur (fuqinë punëtore, dhe pajisjet montuese dhe demontuese), Transporti me mjete alternative kuaj , traktorë deri aty ku ka mundësi të depërojnë pasaj me dorë duke angazhuar fuqinë punëtore		komplet	1	€	100.00	€	100.00
Punët Furnizuese dhe montuese të fittingjeve të rrjetit të ujësjellësit prej kaptazhës, ujëmbledhës deri në furnizimin me ujë të rezervuarit							
9.2.1	Lidhëse këndore 90 shkallë -Lidhëse me flanaxhë Gusit DN90/90	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.2	Redukues (FFR) me flanaxhë Gusit DN 90/63 mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.3	Gjysëm lidhëse me flanaxhë për gyp PE (alkaten) Ø90/90mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.4	Gjysëm lidhëse me flanaxhë për gyp PE (alkaten) Ø90/90mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.5	Flanaxhë mbyllëse me tapë DN 63mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.6	Adapter flanaxhë PE (Me salldim) DN 63 mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.7	Adapter flanaxhë PE (Me salldim) DN 90mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
9.2.8	Valvulë Ajri 16 bar me një kokë (GGG) DN 80 mm	copë	2	€	20.00	€	40.00
Valvulë me teleskop DN 90 mm , (H= 1-1.5 m për DN 80-100 mm) për shkyqje dhe kyqje të lagës, në qmim kalkulohet edhe elementet përcjellëse							
9.3.1	Valvulë shiber 16 bar (GGG) DN 100 mm	copë	1	€	20.00	€	20.00



9.3.2	Kapaka për teleskopa së bashku me garniturën e pjesëve fazonike nga materiali Gus DN 100mm, duke përfshirë edhe përfundimin dhe nivelimin e kapakut me nivelin konfiguracionit terrenit	copë	1	€	20.00	€	20.00
9.3.3	Ventila së bashku me garniturë të pjesëve fazonike montuese DN 100 mm	copë	1	€	20.00	€	20.00
9.3.4	Furnizimi dhe montimi i pjesëve fazonike montuese të parapara përgjatë rrejtit të ri si dhe atijë ekzistues, me kërkesë të banorëve apo organit mbikqyrës. Ulog komplet	komplet	1	€	20.00	€	20.00
10	Gjithsej: Punët montuese (Fitingjet)						€ 6,191.57
Shqyrtimi dhe Testimi i rrejtit							
Me përfundimin e montimit, para mbulimit të kanalit të bëhet testimi hidraulik i gypsjellësit nën presion provues sipas udhësimeve të prodhuesve							
10.1.1	Testimi i rrejtit	m ³	1769.89	€	0.10	€	176.99
Para lëshimit në punë të gypsjellësit është e nevojshme të bëhet dezinfektimi i gypit sipas rregullave të njohura të dhëna në kushtet teknike të							
10.1.2	Dezinfektimi i rrejtit	m ³	1769.89	€	0.10	€	176.99
Gjithsej: Punët e Testimit dhe dezinfektimit të rrejtit							€ 353.98
REKAPITULIMI - RECAPITULATION							
1	Punët Parapregaditore					€	186.00
2	Punët demoluese					€	186.00
3	Punët Tokësore					€	6,634.00
